REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 28.09.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës lidhur me familjet e prekura nga përmbytjet e muajit janar 2026 në zonën e Durrësit të Ri/Ish-Kënetës, ju informojmë si më poshtë:

Lidhur me procesin e dëmshpërblimit, ju bëjmë me dije se deri në momentin e kthimit të kësaj përgjigjeje, familjet e evidentuara si të dëmtuara nga përmbytjet e janarit 2026 nuk janë likuiduar ende, pasi procedura administrative për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve nuk ka përfunduar.

Në vijim të evidentimit të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet, Njësitë Administrative kanë administruar dhe përcjellë pranë strukturave përkatëse të Bashkisë dokumentacionin e paraqitur nga qytetarët, pas plotësimit të praktikave individuale dhe dokumentacionit të kërkuar për secilin rast.

Procesi i administrimit dhe verifikimit të praktikave ka kërkuar kohë për shkak të plotësimit gradual të dokumentacionit nga qytetarët dhe përcjelljes së praktikave nga Njësitë Administrative, si dhe për shkak të fluksit të konsiderueshëm të praktikave administrative të trajtuara nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë.

Në përfundim të këtij procesi, lista përfundimtare e familjeve përfituese do t'i nënshtrohet procedurës përkatëse të miratimit nga Këshilli Bashkiak, në përputhje me kompetencat dhe procedurat e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi. Deri në përfundimin e kësaj procedure dhe miratimin e listës nga Këshilli Bashkiak, nuk mund të kryhet likuidimi i dëmshpërblimeve.

Sa i përket situatës së familjeve të prekura, sqarojmë gjithashtu se individët/familjet e evidentuara në këtë proces kanë përfituar ndërkohë fonde në kuadër të dëmshpërblimeve të parashikuara për dëmet e shkaktuara nga përmbytjet e vitit 2025, sipas procedurave dhe akteve përkatëse të miratuara për këtë qëllim.

Bashkia Durrës është duke vijuar procedurat administrative për përfundimin e praktikave dhe përgatitjen e listës përfundimtare, e cila, pas përfundimit të procedurave të nevojshme, do t'i paraqitet Këshillit Bashkiak për shqyrtim dhe miratim.

Pas miratimit të listës dhe përfundimit të procedurave administrative e financiare përkatëse, do të vijojë procesi i likuidimit të familjeve që plotësojnë kriteret për përfitim.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, ju sigurojmë se procedurat po ndiqen në përputhje me kuadrin ligjor dhe administrativ në fuqi.